

To: olaxama@hotmail.com;

Kthim pergjigje Nr. 151

Përshendetje!

Në pergjigje të kërkesës tuaj dërguar elektronikisht në adresën e Zyrës së Shtypit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në kuadër të Ligjit 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, regjistruar me nr. 151 në regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të ligjit të sipërcituar, ju informojmë si më poshtë vijon:

Në lidhje me sa kërkohet nga ana juaj, ju informojmë se, nga verikimet paraprake të deritanishme dhe nga informacioni i marrë nuk rezulton që TIA të ketë detyrim të papaguar për shumat e arkëtuara nga shoqëritë ajrore të tarifës së kalimit me avion të kufirit si dhe nuk rezulton të ketë detyrime të mbartura më shumë se 1 vit.

Për TIA është ushtruar kontroll i fundit në qershor 2014 nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe aktualisht shoqëria është planifikuar për kontroll të plotë tatimor ku pritet të saktësohet dhe zbatueshmëria nga TIA e Udhezimit Nr. 1917 dt. 01.09.2019 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të RSH".

Shuma e paguar nga TIA për tarifën e kalimit të kufirit me avion, për vitin 2019, është 1,836,641,566 Lekë.

Faleminderit per mirekuptimin.

Pune te mbare

Hermelinda Hysena,  
Specialiste e Sektorit te Asistences dhe Sherbimit  
Drejtoria e Sherbimit ndaj Tatimpaguesve  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE  
Tel Office : 04 2276 840  
Web: [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al)

To:olaxama@hotmail.com; Mon 2/3/2020 2:16 PM

Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion lidhur me pergjigjen Nr. 151

Pershendetje !

Në vijim të kërkesës tuaj për informacion në bazë të ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ju informojmë si më poshtë vijon:

*Pika 1. Sa është regjistrimi i tarifës së kufirit në sistemin e IATA-s për vitin 2017, 2018 dhe 2019?*  
Përsa i takon regjistrimit të tarifës së kufirit në sistemin e IATA-s, ne nuk disponojmë të dhëna dhe nuk kemi detyrimin për t’i patur këto të dhëna. TIA gjithashtu nuk i merr të dhënat nga sistemi i IATA, por i merr ato duke u mbështetur në dokumentin e udhëtimit të pasagjerëve.

*Pika2. Sa është transferuar në fund të çdo viti (2017, 2018, 2019) në llogarinë e Drejtorisë Rajonale Tatimore që mbulon këtë territor për këtë qëllim?*  
Nga sistemi tatimor rezulton se TIA nuk ka asnjë detyrim të papaguar për shumat e deklaruara në sistem. Të dhënat në shifra të detajuar për cdo vit dhe balancat përkatëse janë në pasqyrën në formatin excel bashkëngjitur këtij emaili.

*Pika 3. Sipas Udhëzimit Nr. 1917 dt. 01.09.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të RSH", sa është shuma e arkëtuar për tarifën e kufirit nga shoqëritë ajrore dhe sa janë detyrimet e paarkëtuara?*  
Bazuar në të dhënat e detyrueshme për deklarim nga TIA, si agjent i caktuar me udhëzim për mbledhjen e tarifës së kalimit me avion të kufirit të RSH, rezulton se nuk ka detyrime të papaguara. Përsa i perket detyrimeve të paarkëtuara nga shoqëritë ajrore për TIA, nga informacioni i fundit i kërkuar nga TIA rezulton se shuma e tarifës e papaguar nga të gjitha shoqëritë ajrore ndaj TIA e faturuar deri në dhjetor 2019 është 1,445,290 Euro.

*Pika 4. A janë marrë masa siç parashikohet në udhëzimin Nr. 1917 dt. 01.09.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të RSH" për koncesionarin TIA apo ndonjë shoqëri ajrore për mosrespektim të derdhjes së tarifës së kufirit?*  
Udhëzimi Nr. 1917 dt. 01.09.2014 pika 3, parashikon të drejtat dhe detyrimet e TIA në lidhje me administrimin e Tarifës. TIA në deklarimin e saj dhe nga verifikimet e deritanishme rezulton që ka llogaritur, rakorduar, faturuar dhe njoftuar shoqëritë ajrore për detyrimin e tarifës për muajin përkatës.

Po sipas këtij udhëzimi pika 4, shoqëritë ajrore janë përgjegjëse për arkëtimin e tarifës nëpërmjet shitjes së biletës dhe për përmbushjen e detyrimeve të caktuara në këtë udhëzim në perputhje me tagrin e dhënë në përfaqësim.

*Pika 5. Nëse ka detyrime të prapambetura lidhur me pagesën e tarifës së kufirit, a mund të më vini në dispozicion tabelën sipas shoqërive të fluturimit lidhur me detyrimet që ka secila prej tyre dhe masat e marra nga institucioni juaj ndaj secilës prej shoqërive?*  
Përsa i përket detyrimeve të prapambetura lidhur me pagesën e tarifës, sqarimi është dhënë në përgjigje të pikës 3, më lart.

Drejtoria Rajonale Tatimore, sapo është vënë në dijeni për detyrimet të prapambetura që ka një nga shoqëritë ajrore nën juridiksionin e saj po ushtron verifikim në vend dhe ka filluar procedurë kontrolli të plotë tek shoqëria përkatëse.

Lidhur me tabelën për cdo shoqëri ajrore balanca e detyrimeve të papaguara nga shoqëritë është përpunuar dhe dërguar nga TIA, ndërkohë mbetet të verifikohet saktësia e saj pas përfundimit të kontrollit të plotë që do të fillojë së shpejti në këtë shoqëri.

Faleminderit për mirëkuptimin.

Pune te mbare

Hermelinda Hysenaj  
Specialiste e Sektorit të Asistencës dhe Sherbimit  
Drejtoria e Sherbimit ndaj Tatimpaguesve

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE**

Tel Office : 04 2276 840

Web: [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al)

TIA		Tarifa për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë			
	2020/ Janar	2019	2018	2017	
Detyrim sipas deklarates tatimore		1,828,912,256	1,682,627,457	1,590,152,344	
Paguar per deklarate		1,828,912,256	1,682,627,457	1,590,152,344	
diferenca		0	0	0	
Pageze Cash gjate periudhes	94,698,170	1,836,641,566	1,690,673,395	1,585,749,371	

To:ola <olaxama@hotmail.com>; Mon 2/3/2020 8:22 PM

Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion lidhur me pergjigjen Nr. 151

Cc:Paradhoma Dpt; Ilda Koja; Klajd Shuka;

Pershendetje !

Ne vijim te kerkeses tuaj, sqarojme si me poshte vijon:

Ligji Nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, përcakton llojet e taksave dhe tarifave kombëtare që zbatohen në Republikën e Shqipërisë, nivelin e taksave kombëtare, procedurat e llogaritjes, të arkëtimit dhe transferimit në Buxhetin e Shtetit, ose në buxhetin e njërive të qeverisjes vendore të taksave dhe tarifave kombëtare, si dhe detyrimet që kanë agjentët e taksave dhe tarifave kombëtare.

Ligji sipërcituar në nenin 11 “Tarifa shërbimi” ka përcaktuar se, përveç tarifave të shërbimit, të përcaktuara në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, quhen tarifa shërbimi edhe tarifa për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë.

Më tej ky ligj, përcakton se, agjent i taksave dhe tarifave është personi i cili, sipas kërkesave të këtij ligji, është përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e drejtorive rajonale tatimore, për t’u transferuar, më pas, në Buxhetin e Shtetit, të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat kombëtare.

Në nenin 4/1 “Deklarata për pagesën e taksave kombëtare”, përcaktohet se, personat fizikë dhe juridikë, subjekte të nenit 4, të këtij ligji, si dhe agjentët e taksave, në rastin kur taksat mbledhen me agjentë, detyrohen:

a) të bëjnë një deklaratë për çdo muaj, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhet deklarimi;

b) të paguajnë taksat kombëtare për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës;

Deklarata, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, bëhet në formën dhe përmbajtjen që përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

**Referuar përcaktimeve të mësipërme, në deklaratën e taksave kombëtare, agjentët e taksave plotësojnë rubrikën përkatëse me një shumë kumulative (totale), për të gjithë subjektet me shifra dhe nuk japin informacion të detajuar për subjektet të cilëve u është llogaritur, mbledhur dhe paguar në buxhet e shtetit kjo shumë.**

Referuar kuadrit ligjor të sipërcituar, DPT nuk disponon një informacion të detajuar sipas shoqërive të fluturimit. Këtë informacion administrata tatimore, mund ta sigurojë vetëm në përfundim të kontrollit tatimor tek subjekti TIA, kontrolli i cili ka nisur.

Për më shumë informacion në lidhje me kërkesen tuaj mund t'i drejtoheni TIA-s.

Faleminderit per mirekuptimin.

Pune te mbare

Hermelinda Hysenaj  
Specialiste e Sektorit te Asistences dhe Sherbimit  
Drejtoria e Sherbimit ndaj Tatimpaguesve

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Tel Office : 04 2276 840

Web: [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al)